



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

Kabineti i Ministrit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 61/2015  
Datë: 13.05.2015

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L – 189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe nenin 8 (paragrafi 1,2,3 dhe 4), të Ligjit Nr. 04/L – 97 për Bibliotekat, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Këshilli Drejtues i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”.
2. Këshilli Drejtues përbëhet prej pesë anëtarëve si në vijim:
  - 2.1. Kadri Metaj
  - 2.2. Bardh Rugova
  - 2.3. Muhamet Hamiti
  - 2.4. Fazli Gajraku
  - 2.5. Feim Hoxha, përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Këshilli Drejtues emërohet me mandat 4 (katër) vjeçar dhe është përgjegjës të ushtrorë të gjitha kompetencat e përcaktuara me Nr. 04/L-97 të Ligjit për Bibliotekat.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues kompensohen financiarisht për punën e tyre.
5. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro për Kryetarin, ndërsa 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e Këshillit për secilën mbledhje.

6. Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues lejohet më së shumti për dy mbledhje të mbajtura gjatë muajit.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit të Kulturës;*
- *Bibliotekës Kombëtare të Kosovës;*
- *Palëve;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MKRS – së;*

